



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇËSHTJEVE DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE

Nr. 3333 prot.

Tiranë, më 28.07.2021

U R D H Ë R

Nr. 123, datë 28.07.2021

“PËR
DELEGIMIN E KOMPETENCËS PËR NËNSHKRIMIN E DOKUMENTEVE
ADMINISTRATIVË QË DALIN NGA ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË
DREJTËSISË”

Në mbështetje të nenit 147/d të Kushtetutës, dhe në zbatim të nenit 204, pika 1, shkronja “c” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, dhe neneve 28 - 29 të ligjit nr. 44/20151 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

U R D H Ë R O J :

1. Delegimin e kompetencës së nënshkrimit të dokumenteve administrative që dalin nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas fushës së përgjegjësisë që mbulon Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve dhe Shërbimeve Juridike dhe Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.
2. Ngarkohet Znj. Dëshira Pasko, Sekretar i Përgjithshëm, për nënshkrimin e dokumenteve që dalin nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që lidhen me:
 - a. Kërkesat për informacion të publikut;
 - b. Kërkesat për informacion nga institucionet e sistemit të drejtësisë;
 - c. Informacionet në kuadër të përgatitjes së raportimeve dhe të dhënave statistikore për veprimtarinë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
 - d. Kërkesat të cilat nuk janë kompetencë e njësisë së inspektorëve;
 - e. Korrespondenca që lidhet me çështje dhe shërbime juridike;
 - f. Aktet në zbatim të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Kodi i Punës, për personelin administrativ, të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij urdhri, ngarkohen njësitë që administrojnë kërkesat e ardhura apo që u drejtohen subjekteve të përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri, të hartojnë ekzemplarët e shkresave dalëse sipas përcaktimeve të këtij urdhri dhe në përputhje me parashikimet e

bëra në urdhrin nr. 8, datë 21.01.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për njehsimin e dokumentit administrativ”.

4. Urdhri nr. 4, datë 08.01.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ”Për delegimin e kompetencës për nënshkrimin e dokumenteve administrative që dalin nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, si dhe urdhri nr. 117, datë 06.07.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për delegimin e kompetencës për nënshkrimin e dokumenteve administrative që dalin nga Zyra e Inspektorit të Lartë Drejtësisë”, shfuqizohen me miratimin e këtij urdhri.
5. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse për zbatimin dhe njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare. .

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Artur Metani

